

Në bazë të nenit 160 paragrafi (3) të Ligjit për arsim të lartë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 82/18 dhe "Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr.178/21), dhe nenin 22 paragrafi (1) alinea 1, nenin23, nenin 24, nenin 25, nenin 26 dhe nenin 27 të Ligjit për marrëdhëniet e punës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 62/05, 106/08, 161/08, 114/09, 130/09, 50/10, 52/10 , 124/10, 47/11, 11/12, 39/12, 13/13, 25/13, 170/13, 187/13, 113/14, 20/15, 33/15, 72/15, 129 / 15, 27/2016, 120/18 dhe "Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr.110/19, 267/20, 151/21, 288/21 dhe 111/23), Universiteti "Nënë Tereza" në Shkup shpall

KONKURS PUBLIK

për punësim të 4 (katër) personave në kohë të pa caktuar edhe atë:

1. ROJTAR(2) përmbarues
2. PORTIR (2) përmbarues

Kandidatët për këtë vend pune duhet t'i plotësojnë kushtet e mëposhtme:

- **Arsim fillor ose Arsim të mesëm;**
- **Me ose pa përvojë pune.**

Shuma neto e pagës bazë arrin deri 22.101,00 denarë.

Për pozitën numër 1 përparësi do të kenë kandidatët që posedojnë licencë për sigurim

Kandidatët përveç kushteve të posaçme të lartëpërmendura, duhet të plotësojnë edhe kushtet e përgjithshme në vijim:

- ✓ Të jenë shtetas të Republikës së Maqedonisë së Veriut
- ✓ Në mënyrë aktive ta njih (përdorë) gjuhën maqedonase;
- ✓ Të jenë të moshës madhore;
- ✓ Të kenë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës;
- ✓ Të ketë vendim nga gjykata se nuk ka të shqiptuar ndalesë për kryerjen e profesionit, veprimtarisë apo detyrës.

Të drejtë aplikimi kanë të gjithë qytetarët e Republikës së Maqedonisë së Veriut të cilët i plotësojnë kushtet për të aplikuar.

Kandidatët së bashku me fletë aplikimin duhet të dorëzojnë edhe dëshmitë se i plotësojnë kushtet, në formë origjinale ose të vërtetuara nga noteri, edhe atë:

1. Dëshmi mbi shtetësinë e Republikës së Maqedonisë së Veriut
2. Dëshmi e shëndetit të përgjithshëm për vendin e punës – Certifikatë nga Instituti i Mjekësisë së Punës (jo më të vjetër se 6 muaj)
3. Dëshmi se nuk i është shqiptuar ndalesë për kryerjen e profesionit, veprimtarisë apo detyrës (jo më të vjetër se 6 muaj),
4. Certifikata / Diploma për nivelin e kryer arsimor në përputhje me kërkesat në konkurs;
5. Dëshmi mbi përvojën e punës;

Afati për dorëzimin e fletë aplikimeve me dokumentet e kërkuara do të zgjasë **5 ditë pune** nga dita e shpalljes së

konkursit (duke përjashtuar ditën e shpalljes).

Kushtet e përcaktuara në konkurs, kandidatët duhet t'i plotësojnë në momentin e aplikimit.

Nëse në konkurs paraqiten 200 kandidatë, zgjedhja do të bëhet brenda 45 ditëve, nga 201 deri në 500 kandidatë, zgjedhja do të bëhet brenda 90 ditëve dhe më shumë se 500 kandidatë, zgjedhja duhet të bëhet brenda 120 ditëve, pas afatit për aplikim.

Fletë aplikimet me dokumentet e kërkuara duhet të dorëzohen në një zarf të mbyllur në kampusin e Universitetit "Nënë Tereza" në Shkup, në ish Kazermën Ilinden, kati i 3-të zyra nr. 308, me shënimin "konkurs për punësim në Universitet, për vendin e punës numër ____."

Fletë aplikimet jo të plota dhe ata që nuk i dorëzojnë në kohën e duhur nuk do të merren parasysh.

Afati i fundit për aplikim: 17.11.2023.

Kontakt telefoni: 02/3161-004

Me respekt,

Universiteti "Nënë Tereza" në Shkup